



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Slobodnih Profesija-
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPSDPLS.nr.17/2024

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushë Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat, _____, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga _____ nga _____, komuna e _____, të cilin me autorizim e përfaqëson _____, avokat nga _____ lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, e mbajtur në prezencën Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira, Burbuqe Spahija Kërveshi, e Përmbaruesit Privat, dhe përfaqësuesi i palës ankuese, në seancë dëgjimore, me datë 09.12.2024, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet poshtë si e pas afatshme, ankesa e palës ankuese _____ nga _____, komuna e _____, e paraqitur me datë 15.10.2024, kundër Përmbaruesit Privat, _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në _____.

A r s y e t i m

Pala ankuese, me datë 15.10.2024, ka paraqitur ankesë ndaj Përmbaruesit _____ si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në _____.

Pala ankuese pretendon në ankesë se përmbaruesi privat me veprimin përmbarimor të datës 12.10.2020, ka bërë bllokimin e llogarive , arësye kjo për të cilën ka parashtruar ankesë mëdatë 28.10.2024, në Ministrinë e Drejtësisë, lidhur me shkelje disiplinore.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe statistika - Divizioni për Profesione të Lira, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë duke mbetur në tërësi pranë raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 09.12.2024.

Përmbaruesi Privat, në seancën dëgjimore ka deklaruar se ankesa e palës ankuese është e pas afatshme, sepse veprimi i fundit përmbarimor lidhur me rastin lëndor është marrë më larg se 1 vit, para se të parashtrohet ankesa.

Komisioni pas vlerësimit të afatshmërisë së ankesës së paraqitur nga pala ankuese gjeti se ankesa është paraqitur pas afatit ligjor, siç përcaktohet me nenin 375 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP), në të cilën përcaktohet se periudha brenda së cilës mund të inicohet procedura disiplinore nga shkelja e pretenduar është si në vijim: “ *Procedura disiplinore mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes*”. Nga kjo rezulton se ankesa e palës ankuese është e paraqitur pas afatit ligjor të lartcekur ,ngase veprimi i fundit përmbarimor i pretenduar nga pala ankuese si shkelje e veprimeve përmbarimore nga përmbaruesi, është i datës 12.10.2020, ndërsa ankesa nga pala ankuese është paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë me datën 15.10.2024.

Për këto arsye, komisioni nuk u lëshua mëtej në vlerësimin e meritave të kësaj ankese.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPSDPLS.nr.17/2024 datë 09.12.2024**

**Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi**



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij konkluzioni pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.